



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 454 Prot

Shkodër, më 12.1. 2023

KONTRATË QIRAJE

E lidhur sot me datën 12. 1.2023, mes palëve:

1. Bashkia Shkodër, institucion publik me nr NIPT K36813001H, me adrese: Rr. 13 Dhjetori Shkodër, përfaqësuar nga Kryetar Z. Bardh Spahia, madhore e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, që më poshtë do të quhet “Qiradhënsi”.

Dhe

2. Subjekti “Bashkim Vllaznim” shpk – me nr NIPT K86713016K me adrese te zyres qendrore: Rr. Nacionale Shkoder-Grude e Re nr. pasurie 254/1 ZK 1869, Vorret Publike Stom Golem, Shkoder me administrator Z.Agim Tahiri, lindur në Shkodër dhe banues në Shkodër, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, që më poshtë do të quhet “Qiramarrsi”.

BAZA LIGJORE:

Ligji nr.7850 dt. 29.07.1994 “Kodi civil i Republikës së Shqipërisë” te ndryshuar.

Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

VKM nr.54 dt. 05.02.2014 “Per percaktimin e kriterëve, te procedurës dhe te menyres se dhenies me qira, enfiteoze apo kontrata te tjera te pasurise shteterore”, të ndryshuar .

Palët bien dakort sa më poshtë:

**Neni 1
Objekti i kontrates**

Objekti i kesaj kontrate eshte dhenia me qira e pasurise se paluajtshme me sipërfaqe 12 m², nr.pasurie 3/159-N32, në zonën kadastrale 8594, volum 30, faqe 147, ndodhur në qytetin Shkodër, pasuri në pronësi të bashkisë Shkodër, bashkëlidhur planimetria.

**Neni 2
Qellimi i kontrates**

Qellimi i kësaj kontrate është dhenia me qira e objektit të percaktuar në nenin 1, për zhvillimin e aktivitetit të tij, zyrë shërbimi.

~~N. VLLAZNIMI SHPK
BASHKIM VLLAZNIMI
SHKODER-ALBANIA~~



Neni 3
Afati i kontratës

3.1 Kjo kontratë është e vlefshme për 1(një) vit kalendarik, duke filluar nga data e nënshkrimit të saj, me të drejtë rinovimi me kërkesë të qiramarrësit.

Neni 4
Pagesa e kontrates

4.1 Qiramarrësi detyrohet t'i paguaj qiradhënësit detyrimin mujor/vjetor në vlerën prej 2 088 leke/muaj ose 25 056 leke/vit.

4.2 Pagesa e qirasë do të jetë mujore/vjetore dhe do të bëhet brenda datës 10 (dhjetë) të fillimit të muajit për llogari të institucionit (Bashkia Shkodër), në llogarinë e të ardhurave, Dega e Thesarit Shkodër.

Neni 5
Të drejtat dhe detyrimet e qiradhenesit:

5.1 Qiradhënësi (Bashkia Shkodër) merr përsiper t'i dorëzojë qiradhenesit sendin sipas përshkrimit në nenin 1, në kohën e caktuar dhe në gjendje që të lejojë përdorimin për të cilën palet janë marrë vesh.

5.2 Qiradhenesi (Bashkia Shkodër) është i detyruar të garantojë gezimin e qetë të sendit, objekt i kësaj kontrate.

5.3 Qiradhenesi (Bashkia Shkodër) nuk përgjigjet për pretendime të tjera që nuk kanë të bëjnë me objektin dhe qëllimin e kontrates.

5.4 Qiradhenesi (Bashkia Shkodër) ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontrates, kur qiramarrësi shkel detyrimet e marra përsiper për dy periudha rresht, duke e njoftuar këtë të fundit 1(një) muaj më përpara me shkrim.

Neni 6
Të drejtat dhe detyrimet e qiramarrësit:

6.1 Qiramarrësi (Bashkim Vllaznim shpk), duhet ta përdorë pasurinë objekt i kësaj kontrate vetëm për qëllimin dhe destinacionin e parashikuar në nenin 2.

6.2 Qiramarrësi (Bashkim Vllaznim shpk), duhet të paguajë detyrimin mujor/vjetor të qirase brenda afatit të përcaktuar në nenin 4 (kater) të kontrates.

6.3 Qiramarrësi (Bashkim Vllaznim shpk), merr përsiper të paguaj të gjitha detyrimet që rrjedhin nga tatimet, konsumi i energjisë elektrike, konsumi i ujit, gjatë zhvillimit të aktivitetit në ambientin e sipërcituar, që rëndojnë mbi pronën e dhënë me qira.

6.4 Qiramarrësi (Bashkim Vllaznim shpk), nuk ka të drejtë ta shesë, ta japë me qira pronën të treta.

6.5 Qiramarrësi (Bashkim Vllaznim shpk), merr përsiper ruajtjen e objektit nga ana e tij.

6.6 Qiramarrësi (Bashkim Vllaznim shpk), nuk ka të drejtë të tjetërsojë objektin.



11.3 Palet kontraktuese rane dakort sa mesiper dhe kjo kontrate u pergatit dhe u nenshkrua në 4 (kater) kopje origjinale.

Për Bashkinë Shkodër

Kryetar

Z. Bardh Spallia



Për "Bashkim Vllaznim Shpk"

Administrator

Z. Agim Tahiri

~~N. VERTIMI SHPK
BASHKIM-VLLAZNIM
SHKODER-ALBANIA~~